



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR EMËRIMIN KRYESISHT TË ANËTARËVE DHE SEKRETARËVE
TË KZAZ-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 09.04.2019, me pjesëmarrjen e

| | | |
|---------|-----------|-----------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zëvendëskryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për emërimin kryesisht të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 29, pika 5, neni 30, neni 31, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 18, datë 1.02.2019, dhe vendimin nr. 19, datë 1.02.2019, ka përcaktuar partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të ngrihen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Brenda afatit ligjor të përcaktuar në aktet sipërcituar, paraqiti propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve vetëm nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Nuk janë paraqitur propozime për të plotësuar përbërjen e KZAZ-ve nga parti politike të tjera, as brenda afatit ligjor dhe as në tejkalim të tij.

Pas emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, me vendimin e KQZ nr. 114, datë 02.04.2019, sipas propozimeve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, konstatohet se :

- Në KZAZ-të me numër tek janë emëruar tre anëtarë, ka një vakancë për plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje;
- Në KZAZ-të me numër çift ka vakancë të pozicionit të sekretarit;



Nr. 141 i Vendimit

Data 09.04.2019 e Vendimit Ora 11⁰⁰

Për emërimin kryesisht të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Në zbatim të nenit 29, pika 5, të Kodit Zgjedhor, nenit 9, pika 4, të Udhëzimit nr. 2, datë 25.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", i ndryshuar, KQZ emëron kryesisht anëtar dhe sekretar për plotësim të vakancës të konstatuar në KZAZ.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.140, datë 9.04.2019, ka miratuar listën emërore të shtetasve të cilët mund t'i emërojë kryesisht për plotësim të vakancave në KZAZ.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për plotësimin e vakancave të konstatuara, në pozicionin e sekretarit në KZAZ-të me numër çift dhe anëtarit të KZAZ-ve me numër tek, përzgjedhi emra nga lista e miratuar. Për zonat zgjedhore ku numri i aplikimeve tejkalonte numrin e vakancës, u zbatua procedura e shortit përcaktuar në nenin 2/1 të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Bazuar në nenin 23, pika, nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të emërojë kryesisht në detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së shtetasit sipas lidhjes Nr.1 bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |



Nr. 141 i Vendimit Data 09.04.2019 e Vendimit Ora 11⁰⁰

Për emërimin kryesisht të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019